



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI “ISMAIL QEMALI” VLORË
DREJTORIA E SIGURIMIT TË BRENDSHËM TË CILËSISË DHE ZHVILLIMIT INSTITUCIONAL
SEKTORI I PROJEKTEVE DHE MARRËDHËNIEVE ME JASHTË



ERASMUS+

Thirrje për bursa mësimdhënie/trajnim për stafin akademik dhe ndihmës akademik/administrativ me kohë të plotë në kuadër të Programit “Erasmus +” për komponentin KA1 *International Credit Mobility* në Universitetin e Vigo-s në Spanjë.

Universiteti “Ismail Qemali”, Vlorë në bashkëpunim me **Universitetin e Vigo-s në Spanjë (University of Vigo)**, në kuadër të Programit “Erasmus+” për komponentin KA1, fton të gjithë stafin me kohë të plotë në UV të aplikojnë për bursë për mobilitet mësimdhënie/ trajnimi.

Lloji i mobilitetit përfshin:

- Shkëmbimin e stafit akademik për mësimdhënie/trajnim, i cili lidhet me fushën “**061 Information and Communication Technologies**”
- Shkëmbimin e stafit ndihmës akademik me karakter administrativ për trajnim.
- Kohëzgjatja: 5 + 2 ditë
- Numri i mobiliteteve: 4
- Periudha e mobilitetit: Semestri “Pranverë” i vitit akademik 2023-2024
- Dieta ditore: 160 Euro/ ditë
- Shpenzime udhëtimi: 360 Euro. Shpenzimet e udhëtimit përlllogariten në bazë të largësisë sipas linkut:
https://ec.europa.eu/programmes/erasmus-plus/resources/distance-calculator_en

Kriteret për aplikim për mobilitet mësimdhënie:

- Stafit akademik me kohë të plotë në UV.
- Njohja e gjuhës angleze minimalisht në nivelin B2.

Kriteret e përzgjedhjes:

- Stafit do të vlerësohen nga një komision ndërkombëtar i përbërë nga dy staf akademik prej secilit universitet të përfshirë në mobilitet sipas kriterëve të mëposhtme:
 - Merita akademike (deri më 75%): cilësia dhe rëndësia, projekti propozim, eksperiencia akademike etj.
 - Aspekte të tjera (deri më 25%) : kompetenca gjuhësore, etj.
- Të gjithë kandidatët e përzgjedhur, brenda 60 ditëve pas publikimit të rezultateve, duhet të dërgojnë dokumentin e marrëveshjes lëndore të nënshkruar nga të gjitha palët, i cili duhet të dërgohet në adresën (teleco.subdir.internacional@uvigo.es) me fjalën kyçe [KA171] në fillim të subjekti email-it.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI “ISMAIL QEMALI” VLORË
DREJTORIA E SIGURIMIT TË BRENDSHËM TË CILËSISË DHE ZHVILLIMIT INSTITUCIONAL
SEKTORI I PROJEKTEVE DHE MARRËDHËNIEVE ME JASHTË

Dokumentet e nevojshme për aplikim:

- Formular aplikimi.
- Kopje e dokumentit identifikues / pasaportë.
- CV në anglisht
- Dokument që vërteton statusin e të punësuarit pranë UV-së.
- Vërtetim nga Rektori / Dekani i Fakultetit tuaj që ju lejon të shkëputeni për të kryer mobilitetin.
- Dokument që vërteton njohjen e gjuhës së huaj (Anglisht ose Spanjisht).
- Letër motivimi.

Dorëzimi i dokumentave të aplikimit:

Formulari i aplikimit dhe dokumentat e skanuara duhet të dërgohen në adresën (teleco.subdir.internacional@uvigo.es) me fjalën kyçe [KA171] në fillim të subjekti email-it.

1. Afati i fundit i aplikimit është 25/10/2023.
2. Vlerësimi dhe përzgjedhja e kandidatëve do të jetë në periudhën 30/10/2023-02/11/2023.
3. Publikimi i rezultateve do të jetë në datën 03/11/2023.

Më shumë informacion mbi universitetin pritës dhe katalogun e kurseve në gjuhë të huaj i gjeni në linket:

<https://www.uvigo.gal/>

Për më shumë informacion rreth skemës së mobilitetit dhe mënyrës së aplikimit mund të kontaktoni me:

- Koordinatorin akademik të marrëveshjes ndërinstitucionale Dr. Eva Çipi (eva.cipi@univlora.edu.al)
- Sektorin e Projekteve dhe Marrëdhënieve me Jashtë (internacional@univlora.edu.al).

Universiteti “Ismail Qemali”, Vlorë ju uron suksese!